



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.39 dt.14.02.1997

**“PER
DHENIE FOND PAGE FABRIKES SE RERE SHTUFIT SHKOZE”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.14.02.1997, shqyrtoi relacionin për dhënie fond page për Fabrikën e Rërë Shtufit Shkozë, paraqitur nga Sektori Zhvillimit të Industrisë.Këshilli Bashkiak mbështetur në kompetencat që i jep ligji “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” Nr.7582, dt,10.06.1992, neni.14, pika.10, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.673, dt.29.11.1995 “Për kriteret e përdorimit të të ardhurave të organeve të Pushtetit Lokal”, pika.2, nëndarja.”a”

V E N D O S I;

1. Fabrika e Rërë Shtufit Shkozë ti jepet çdo muaj fondi për pagesën e drejtorit dhe 4 rojeve deri në fund të 3 muajit të parë të vitit 1997, ndërkohë në fund të muajit Mars të këtij viti të paraqitet një relacion shpjegues për gjendjen e praktikave shkresore për privatizimin e kësaj ndërmarrje.

Fondi mujor i pagës duhet të jetë si vijon :

Bujr Abazi.....Drejtor.....Paga 7.544 lekë

Afërdita Allushi.....Roje.....4.658 lekë

Naim Pëllumbi.....Roje..... 4.658 lekë

Skënder Spahiu.....Roje.....4.658 lekë

Agim Spahiu.....Roje.....4.658 lekë

SHUMA : 26.176 lekë

Sig.Shoq. 34.2% x 26.176 = 8952.1 lekë

GJITHSEJ : 35.128 lekë

Nga Sig.Shoqërore të zbritet vlera 2467.9 e llogaritur gabim në muajin dhjetor 1996(paguar tepër, sig.shoqërore gjatë muajit dhjetor 1996).

2. Për kryerjen e pagesës ngarkohet Sektori i Zhvillimit Industrisë dhe Drejtorja e Financës.

**K R Y E T A R I
ORHAN SAKIQI**

KRYETARI

ORHAN SAKIQI